



Pranuar / Doretuar Prilbjen / Predato Received / Delivery	04.05.2023	3	viti god year
Organ / Rjeshta Organ / Jednica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shojca Protog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SEKRETARAT	4043/2023		117



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.542/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Flakron Gashi Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.542/2023 të datës 21.03.2023 të ankueses me adresë banimi: Rruga "Hakif Zejnullahu" P+4, Ulpianë, Komuna e Prishtinës, kundër Vendimit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 04.05.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.542/2023 e datës 21.03.2023 e parashtruar nga ankuesja \_\_\_\_\_a.
- II. Shfuqizohet Vendimi i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës përmes të cilit është refuzuar ankesa e ankueses e datës 17.11.2022.
- III. Anulohet procedura e rekrutimit e shpallur nga Komuna e Prishtinës përmes konkursit të datës 03.10.2022 për pozitën "Specialistë të Përgjithshëm të Shërbimeve Sociale-Zyrtar i Lartë për të Drejta të Fëmijëve", ndërsa shfuqizohet Akti i Emërimit i datës 01.01.2022 me numër:01-112-1199 i kandidatit të përzgjedhur.
- IV. Obligohet Kryetari i Komunës së Prishtinës, të ndërmarrë të gjithë veprimet e nevojshme me qëllim të zbatimit të këtij vendimi si në pikën II dhe III të dispozitivit, në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.
- V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

## Arsyetim

Ankuesja, \_\_\_\_\_, kundër Vendimit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës me datë 21.03.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se Komuna e Prishtinës ka zbatuar gabimisht dispozitat e ligjit material me rastin e shqyrtimit të aplikacionit të saj, pasi që e njëjta e ka bashkangjitur çertifikatën e lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë përmes së cilës dëshmohet se ankuesja nuk është e dënuar gjegjësisht nuk është duke u zhvilluar procedurë penale ndaj saj.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me datë 30.03.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Komuna e Prishtinës, ndërsa Komuna e Prishtinës me datë 14.04.2023 ka dërguar përgjigje në ankesë e cila në Këshill është regjistruar me numër prot:3602/2023.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli:2840/2023 e datës 21.03.2023 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mailin e datës 16.03.2023 dërguar nga F.M.A për ankuesen; Vendimit të datës 24.02.2023 të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës; Vendimit e datës 11.11.2022 të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 30.03.2023; Shkresën zyrtarë të datës 12.04.2023 me referencë:3160/2023; Listën e kandidatëve aplikues; Konkursin e datës 22.06.2022; Listën e renditjes përfundimtare të kandidatëve; Njoftimin për kandidatin e suksesshëm i datës 23.12.2022; Njoftimin për kandidatin e për zgjedhur i datës 28.12.2023; E-mailin e datës 13.04.2023 dërguar nga Sh.I për këshillin; E-mailin e datës 02.05.2023 dërguar nga Këshilli për B.B/DMZP; E-mailin e datës 02.05.2023 dërguar nga B.B për këshillin me korrespondencën e bashkangjitur prej 3 faqesh; Çertifikatën e datës 27.10.2022 lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega Prishtinë; Ankesën me numër protokolli:8506/2022 e datës 28.12.2022 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopjen e konkursit të datës 03.10.2022; Njoftimin elektronik të datës 27.12.2022; Çertifikatën e datës 27.10.2022 lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega Prishtinë; Vendimin e datës 11.11.2022 të Njesisë së Burimeve Njerëzore; Ankesën e parashtruar nga ankuesja në Njësinë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të datës 17.11.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 11.01.2023; Përgjigjen në kërkesë të datës 30.01.2022; Aplikacionin e ankueses të datës 28.10.2022; Diplomën e ankueses të datës 14.01.2009 me numër:15-528-04/1070; Çertifikatën e datës 11.06.2014; Vendimin e Sekretarit të Përgjithshëm të MASHT i datës 10.03.2009; Shkresa e datës 16.10.2020; Çertifikatën e lëshuar nga MASHT; Diplomën e datës 01.10.2022; Licencën e përkohshme të psikologut klinik e datës 12.09.2012; Çertifikatën e datës 09.05.2010; Çertifikatat e lëshuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur; Çertifikatën e pjesëmarrjes lëshuar nga NOKTA; Çertifikatën e datës 01.10. (viti i palexueshëm); Kopjen e letërnjoftimit të ankueses; Vendimin e datës 11.11.2022 për themelimin e komisionit të pranimit; Vendimin e datës 25.11.2022 për themelimin e komisionit të pranimit; Njoftimin e datës 22.11.2022; E-mailin e datës 02.05.2023 dërguar nga Këshilli për F.A, E-mailin e datës 03.05.2023 dërguar nga F.A për këshillin; Dosjen e ankueses Anduena Arrni Uflla, me dokumentacionin e kompletuar; Kopjen e letërnjoftimit të ankueses; Referencën e datës 05.03.2015; Vërtetimin e datës 26.10.2022; Kontratën e punës të datës 13.02.2015;

Vërtetimin e datës 24.03.2015; Vërtetimin e datës 01.04.2023; Kontratën e punës të datës 15.12.2009; referencën e datës 28.08.2009; Vërtetimin e datës 01.04.2011; Referencën e datës 30.08.2009; Referencën e datës 01.09.2009; Vërtetimin e datës 19.11.2008; Çertifikatën e datës 29 maj 2009; Çertifikatën e datës 31.05.2009; Çertifikatën e datës 18.10.2009; Çertifikatën e datës 08-09.06.2009; Çertifikatën e datës 12.07.2009; Çertifikatën e datës 04.10.2020; Çertifikatën e datës 10.01.2020; Vërtetimin e datës 06.03.2010; Çertifikatën e datës 21.02.2010; Çertifikatën e lëshuar nga Soros (*data e palexueshme*); Aplikacionin e datës 25.10.2022 të kandidatit të përzgjedhur P.F; Çertifikatën e datës 17.10.2022 lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega Prishtinë; Vërtetimin e datës 23.06.2022 të Drejtorisë së DMS-së në Komunën e Prishtinës; Kopjen e letërnjoftimit të kandidatit të përzgjedhur; Pasqyrën e trustit lëshuar me datë 12.10.2022; Vërtetimin tatimor të datës 17.10.2022; Letër rekomandimin lëshuar nga BSK; Çertifikatën e lëshuar KCSS për kandidatin e përzgjedhur; Referencën e lëshuar nga KOPF; Çertifikatën e datës 30.07.2020; Çertifikatën e datës 03.07.2016 lëshuar nga PIPS; Çertifikatën e datës 16.11.2010; Çertifikatën e datës 15.02.2008; Çertifikatën e datës 09.12.2007 lëshuar nga YPEER; Çertifikatën e datës 27.05.2007 lëshuar nga USAID-KOPF; Diplomën Nr.1358/14 të datës 16.10.2014 lëshuar nga Kolegji AAB; Akt emërimit e datës 01.01.2023.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankueses është e bazuar, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave nga shkresat e administruara të lëndës, ka gjetur se Komuna e Prishtinës më datë 03.10.2022 ka shpallur konkursin për pozitën "*Specialistë të Përgjithshëm të Shërbimeve Sociale-Zyrtar i Lartë për të Drejta të Fëmijëve*", në të cilin konkurs kishte aplikuar edhe ankuesja Anduena Arni Ufla, mirëpo të njëjtës Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore përmes Vendimit të datës 11.11.2022 i ka refuzuar aplikacionin në fazën e verifikimit paraprak, me arsyetimin se ankuesja nuk e ka bashkangjitur edhe "*Çertifikatën-procedurë penale*" me rasti e aplikimit siç ishte kërkuar me konkurs.

Po ashtu, nga shkresat e lëndës të ofruara në cilësi të provave nga ankuesja, Kolegji i Këshillit ka konstatuar se ankuesja me datë 17.11.2022 kishte parashtruar ankesë në Njësinë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, ankesë e cila bartë vulën e protokollit të Komunës së Prishtinës dhe numër protokollit:14-070/01-251565/22 kundër Vendimit të datës 11.11.2022, mirëpo kjo e fundit nuk ka nxjerrë aktin e kërkuar administrativ nga pala, ndërsa ankuesja kishte parashtruar ankesë në Këshill me datë 28.12.2022 kundër heshtjes administrative, tutje Këshilli me datë 24.02.2023 ka nxjerr Vendimin A.nr.1283/2022 duke aprovuar ankesën e ankueses dhe duke e detyruar Njësinë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës ta shqyrtojë ankesën e ankueses të datës 17.11.2022 të parashtruar pranë saj.

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës sipas vendimit të Këshillit e kishte shqyrtuar ankesën e ankues të datës 17.11.2022 ndërsa me vendim e ka refuzuar ankesën e saj me arsyetimin se e njëjta ankesë e ka parashtruar jashtë afatit prej 3 ditësh sikurse përcaktohet me dispozitat e nenin 15 paragrafi 6 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së arsyetimit të dhënë nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore lidhur me refuzimin e ankesës së ankueses të datës 17.11.2022, Kolegji i

Këshillit ka analizuar dispozitat nenit 15 paragrafi 6 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ku përcaktohet se: *"Brenda tre (3) ditëve nga data e njoftimit individual, në përputhje me paragrafin 5 të këtij neni, kandidatët e njoftuar që nuk plotësojnë kushtet e aplikimit, kanë të drejtë të paraqesin ankesë të brendshme. Ankesa parashtrohet në shkrim pranë Njesisë Përgjegjëse. Ankesa shqyrtohet nga Njësia Përgjegjëse e cila me vendim e njofton kandidatin brenda pesë (5) ditëve nga paraqitja e saj"* dhe ka ardhur në përfundimin se kandidatët në procedurë konkurrimi kanë të drejtë të ankimit në afat brenda tre (3) ditësh të parashtrojnë ankesë pranë Njesisë Përgjegjëse në rastet kur aplikacioni iu refuzohet në fazën e verifikimit paraprak, mirëpo në rastin konkret Njësia Përgjegjëse, gjegjësisht Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës ka harruar faktin sepse me rastin e refuzimit të aplikacionit të ankueses përmes Vendimit të datës 11.11.2022 ia kishte dhënë këshillën juridike që ankuesja ka të drejtë të parashtrojë ankesë pranë Njesisë së Burimeve Njerëzore në afat prej shtatë (7) ditësh, andaj në mbështetje të nenit 127 paragrafi 3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *"Nëse akti administrativ është lëshuar pa informacion, apo me informacion të pamjaftueshëm në lidhje me mjetet juridike administrative (këshillën juridike), afati i parashikuar nga paragrafi 1 i këtij neni, është tre (3) muaj"*, Kolegji i Këshillit Konstaton se arsyetimi i Njesisë së Burimeve Njerëzore është i paqëndrueshëm dhe i kundërligjshëm, ngase të njëjtit ankuesen e kanë qit në lajthitje duke e keqinterpretuar nenin 15 paragrafi 6 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, gjegjësisht duke e këshilluar të njëjtën në të drejtën e shfrytëzimit ankimor në afat prej shtatë (7) ditësh, prandaj mbi këtë bazë pretendimi ankimor i ankueses është i bazuar ndërsa Vendimit i datës 11.11.2022 i Njesisë së Burimeve Njerëzore është i kundërligjshëm sikurse përcaktohet me nenin 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 dhe 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative për shkak të shkelje procedurale administrative dhe ligjit material.

Kolegji i Këshillit me qëllim të vlerësimit nëse konkursi i shpallur nga Komuna e Prishtinës është zhvilluar në pajtueshmëri me parimet e përgjithshme të pranimit në Shërbimin Civil, me datë 02.05.2023 përmes e-mailit i është drejtuar Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik me kërkesën nëse ankuesja . me rastin e aplikimit në konkursin e datës 03.10.2022 për pozitën *"Specialist të Përgjithshëm të Shërbimeve Sociale-Zyrtar i Lartë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve"* me numër Reference RN00009928, ka bashkangjitur edhe Çertifikatën e lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega Prishtinë të datës 27.10.2022, ndërsa Këshilli me datë 03.05.2023 përmes e-mailit ka pranuar përgjigje nga Drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, përmes së cilës konfirmohet fakti se pretendimi ankimor i ankueses e cila qëndronte pran deklarimit të saj se e njëjta e kishte bashkangjitur edhe *"Çertifikatën-procedurë penale"* është pretendim i bazuar, ngase Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik dëshmoi me provën e njëjtë sepse ankuesja me rastin e aplikimit e kishte bashkangjitur në sistem edhe çertifikatën e lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega Prishtinë e datës 27.10.2022, prandaj Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës me rastin e refuzimit fillestar të aplikacionit të ankueses përmes Vendimit të datës 11.11.2022 në fazën e verifikimit paraprak me arsyetim se e njëjta nuk ka bashkangjitur edhe *"Çertifikatën-procedurë penale"* me rastin e aplikimit është arsyetim i paqëndrueshëm sikurse edhe veprim në kundërshtim me nenin 15 paragrafi 2 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ku përcaktohet se: *"Verifikimi paraprak kryhet nga Njësia Përgjegjëse, në bazë të dokumenteve*

të paraqitura si pjesë e aplikimit dhe verifikimeve të tjera sipas detyrës zyrtare që ndërlidhen me verifikimin paraprak” ngase sipas shkresave të lëndës dhe konstatimit të gjendjes faktike lenë të kuptohet që aplikacionin e ankueses nuk e kanë shqyrtuar sipas detyrës zyrtare dhe obligimeve ligjore që kanë, gjegjësisht ia kanë mohuar të drejtën për pjesëmarrje në fazat e tjera të konkursit.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit nga shkresat e lëndës ka gjetur se në konkursin e datës 03.10.2022 të shpallur konkursin nga Komuna e Prishtinës për pozitën “Specialistë të Përgjithshëm të Shërbimeve Sociale-Zyrtar i Lartë për të Drejta të Fëmijëve”, kriteret e konkursit kanë qenë: “Arsimimi i kërkuar-Diplomë të Studimeve Universitare me të paktën 180 kredi/ETCS apo ekuivalente me to, Kualifikime të posaçme formale- Diplomë në shkenca sociale, gjuhë angleze, pedagogji; Përvoja e punës: Së paku dy (2) vite përvojë pune në fushën profesionale”, andaj me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së përcaktimit të kriterëve posaçme formale, Këshilli me datë 02.05.2023 përmes e-mailit i është drejtuar menaxherit të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës me kërkesën për prova shtesë, citoj: “Përshkrimin e aprovuar të detyrave të punës për pozitën “Zyrtar i Lartë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve”, mirëpo në përgjigjen e marrë të datës 03.05.2023 Këshilli ka pranuar sërish vetëm konkursin e shpallur të datës 03.10.2022, andaj në mbështetje të Rregullores Nr.26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil bashkëlidhur me Shtojca Nr. 2: Grupet Tip të administrimit të përgjithshëm dhe posaçëm lidhur me pozitën “12.Gr. Specialist të Përgjithshëm të Shërbimeve Sociale” ka konstatuar se arsimimi i kërkuar është si vijon : “Psikologji/ Punë Sociale dhe të ngjashme”, nga rrjedh se Komuna e Prishtinës me rastin e përcaktimit të kriterëve shtesë të kualifikimeve të posaçme formale sikurse “Diplomë e Gjuhës Angleze”, kriter ky i cili nuk është i përcaktuar me dispozitat e kësaj rregullore madje një kualifikimi i tillë “kualifikimi apo Diplomë e Gjuhës Angleze” nuk është i aprovuar as me rastin e përcaktimit të përshkrimit të detyrave të punës për pozitën “Zyrtar i Lartë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve”, ngase në të kundërtën Menaxheri i Burimeve Njerëzore do ta kishte ofruar në cilësi të provës së kërkuar, nga rrjedh se Komuna e Prishtinës me rastin e shpalljes së këtij konkursi duke përcaktuar kriteret shtesë të kualifikimeve ka vepruar në kundërshtim edhe me parimet e përgjithshme të pranimit të përcaktuar me nenin 6 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik.

Tutje nga shkresat e lëndës konstatohet fakti se, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës, ka bërë publik Njoftimin e datës 28.12.2022 për përzgjedhjen e kandidatit të suksesshëm P.F, njoftim ky i cili nuk përmbante këshillin juridike në frymën e nenit 31 paragrafi 1 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, rrjedhimisht Komuna e Prishtinës kandidatit të përzgjedhur sipas njoftimit të datës 28.12.2022 në të njëjtin ditë ia ka lëshuar edhe aktin e emërimit me shifër Nr.01-112-1199, duke vepruar kështu në kundërshtim edhe me nenin 144 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: “Një akt administrativ do të bëhet i ekzekutueshëm me: 1.1. skadimin e afatit për ankesën kundër tij, nëse një ankesë e tillë nuk është parashtruar; 1.2. njoftimin e palës, me aktin, kur sipas ligjit, nuk lejohet ankesa; 1.3. njoftimin e palës me aktin, kur, sipas ligjit, ankesa nuk ka efekt pezullues 1.4. njoftimin e palës me aktin e ndalimit të efektit pezullues të ankesës, në pajtim me paragrafin 3 të nenit 130 të këtij Ligji, apo 1.5. njoftimin e palës për refuzimin e ankesës” pasi që në rastin konkret asnjëri nga parakushtet e përcaktuara të kësaj dispozite nuk janë përmbushur, ngase ankuesja fillimisht kishte hapur kontest administrativ pranë Komunës së Prishtinës përmes ankesës së datës 17.11.2022 pastaj kundër heshtjes administrative të Komunës së Prishtinës përmes ankesës në Këshill me datë 28.12.2022 dhe se nenin 130 paragrafi 1 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative

përcakton se: *“Përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj, parashtrimi i një ankese pezullon, sipas fuqisë së ligjit, prodhimin e pasojave juridike të aktit administrativ, deri në njoftimin e vendimit që zgjidh ankesën”.*

Kolegji i Këshillit thekson faktin se nga administrimi i shkresave të lëndës, konstatimit të gjendjes faktike dhe analizimit të dispozitave ligjore në mbështetje të arsytimit të dhënë si më lartë në këtë vendim, konstaton se Komuna e Prishtinës, gjegjësisht Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore me rastin e zhvillimit të procedurave të rekrutimit të shpallur përmes konkursit të datës 03.10.2022 për pozitën *“Specialist të Përgjithshëm të Shërbimeve Sociale-Zyrtar i Lartë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve”*, ka bërë shkelje të nenit 15 paragrafi 1 dhe 6 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës me rastin e mos shqyrtimit të aplikacionit, dhënies gabimisht të këshillës juridike dhe mos shqyrtimit fillestar të ankesës, ka bërë shkelje të dispozitave të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës lidhur me përcaktimin e kriterëve shtesë të kualifikimit, ka bërë shkelje të nenit 131 dhe 144 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, për shkak se kandidatit të përzgjedhur i ka lëshuar akt emërimit pa iu dhënë mundësia kandidatëve në procedurë të drejtën e ankimit në Këshill, gjegjësisht po u udhëzuar të njëjtit në këshillë juridike sikurse përcaktohet me dispozitat e nenit 31 paragrafi 1 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, prandaj në Kolegji i Këshillit konstaton se procedura e rekrutimit të shpallur përmes konkursit të datës 03.10.2022 për pozitën *“Specialist të Përgjithshëm të Shërbimeve Sociale-Zyrtar i Lartë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve”*, është përcjell me shkelje flagrante të parimeve të përgjithshme të pranimit në shërbimin civil të përcaktuara me nenin 6 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: *“Pranimi në detyrë i nëpunësit civil, nëpunësit të Shërbimit Publik dhe nëpunësit administrativo-teknik dhe mbështetës, bazohet në parimet e mundësive të barabarta, meritës dhe integritetit, mosdiskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë dhe proporcional gjinor dhe të komuniteteve. 2. Pranimi, sipas paragrafit 1 të këtij neni, kryhet nëpërmjet një procesi përzgjedhës profesional, transparent e të drejtë, që garanton mundësi të barabarta për kushte të barabarta dhe përzgjedhjen e kandidatëve më të kualifikuar për kryerjen e detyrave përkatëse, duke garantuar përfaqësim minimal të komuniteteve dhe të gjinive”*

Prandaj nga se u tha si më lartë, Kolegji i Këshillit njëzëri ka ardhur në konstatimin se ankesa e ankueses Anduena Arrni-Ufla e datës 21.03.2023 është e bazuar dhe e njëjta aprovohet sikurse në dispozitiv të këtij vendim, ndërsa procedura e rekrutimit e kontestuar si në këtë ankesë anulohet sikurse edhe çdo procedurë tjetër apo akt tjetër administrativ që rrjedh prej saj është shfuqizuar për shkak të konstatimit të shkelje të dispozitave të ligjit material dhe akteve nënligjore që rrjedhin prej tij sikurse edhe dispozitave të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.



**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**  
Lënda me numër **A.nr.542/2023**

**Flakron GASHI**

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

**Eshref SHABANI**

Kryetar i Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Prishtinës
- Arkivit të KPMSHCK-së